



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 299 Prot.

Tiranë, më 15.03.2023

VENDIM

Nr. 10, datë 15 /03/2023

MBI

**“MIRATIMIN NË FAZË TË DYTË TË DOKUMENTACIONIT PËR PËRJASHTIM
NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË TË
STUDIMEVE (BACHELOR) PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 NË UNIVERSITETIN
E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar), në Urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 79, dt.01.11.2022, “Fillimin e pranimeve të aplikimeve, nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2022-2023, në Universitetin e Arteve, shkresës nr. 68 prot., datë 26.01.2023 të FM dhe nr. 1688/3 prot., datë 26.01.2023 të UART, shkresës nr. 74 prot., datë 27.01.2023 të FM dhe nr. 1688/2 prot., datë 30.01.2023 të UART, shkresës nr. 20 prot., datë 26.01.2023 të FAS dhe nr. 1688/4 prot., datë 26.01.2023 të UART, si dhe bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga çdo student aplikues në përmbushje të kriterëve të përcaktuara për përfitim dhe sipas akteve të dala për këtë qëllim, Bordi i Administrimit, pas shqyrtimit dhe diskutimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin në fazë të dytë për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve aplikues renditur në *Shtojcën nr. 1* bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

e parë të studimeve Bachelor pranë të Fakultetit të Muzikës dhe Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2022-2023.

2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës dhe Fakulteti i Artit Skenik pranë Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ

(Kryetar)

Jeton SHEHU

(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Prof. Besnik Bisha

(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI

(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

(Anëtar)

Vladimir Llakaj

(Anëtar)

